

VENDIM
Nr. 256, datë 17.12.2018

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “BALKGAZ” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË GAZIT NATYROR (SHITJE ME SHUMICË)

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 22, pika 2, germa “ç”; nenit 83, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”; si dhe nenit 4, pika 1, germa “ç”; neneve 5; 8, 9 dhe nenet 11 dhe 12, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”; miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017; nenit 15 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.12.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, lidhur me licencimin e shoqërisë “Balkgaz” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë),

konstatoi se:

- Me shkresën me nr. 704 prot., datë 5.11.2018, shoqëria “Balkgaz” sh.p.k., ka aplikuar në ERE për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë).

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 241, datë 15.11.2018, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Balkgaz” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë).

- Në vijim të kësaj vendimmarrje u publikua në medie njoftimi me nr. 55/70 prot., datë 19.11.2018 në lidhje me fillimin e kësaj procedure. Po ashtu, me shkresën nr. 704/2 prot., datë 21.11.2018, iu kërkuar subjektit plotësimi i dokumentacionit të munguar.

- Subjekti, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 704/3, datë 3.12.2018, ka paraqitur pjesërisht plotësimin e dokumentacionit të munguar, si dhe shpjegimet përkatëse.

- Në mbledhjen e datës 11.12.2018, u shty relacioni nr. 88/6 prot., datë 6.12.2018, “Mbi licencimin e shoqërisë “Balkgaz” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë)”, për të sqaruar me subjektin çështjet që prekin sasinë e gazit të parashikuar për t’u tregtuar, si dhe infrastrukturën me të cilën do operohet nga subjekti.

- Në vijim, ERE, me shkresën nr. 704/4 prot., datë 11.12.2018, ftoi përfaqësuesit e “Balkgaz” sh.a. për të marrë pjesë në seancën dëgjimore të datës 13.12.2018, për të diskutuar në lidhje me sa më sipër.

- Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesit e subjektit deklaruan se interesi kryesor i shoqërisë “Balkgaz” sh.p.k. është operimi në tregun shqiptar të gazit natyror dhe zbatimi i parashikimeve të Plan-Biznesit do të varet nga koncepti i ngritjes së biznesit nga ky operator. Ata shprehën se janë të ndërgjegjshëm për mungesën e infrastrukturës në vend, por shpjeguan se Plan-Biznesi është një parashikim për të ardhmen. Po ashtu ata deklaruan se e ardhmja do të varet edhe nga kontratat që do të nënshkruajnë pas disponimit të licencës nga ERE. Këto kontrata do të përmbajnë të dhëna konkrete për sasinë e gazit natyror që do të tregtohet, por kjo gjë mund të realizohet vetëm pas pajisjes me licencë nga ERE. Gjithashtu, edhe për garancinë e cilësisë së gazit natyror, sikurse është shprehur edhe më parë në korresponcencat e tij me ERE-n, subjekti deklaroi se do të jetë në gjendje ta përcjellë atë në ERE në momentin e kontraktimit me palët e treta. Subjekti tregoi gatishmëri të plotë për të depozituar në ERE përgjatë kohës kontratat që do të lidhë dhe çdo dokument që do t’i kërkohej.

- Nga analiza që iu bë dokumentacionit të aplikimit të shoqërisë “Balkgaz” sh.p.k., si dhe dokumentacionit të përcjellë nga subjekti, me anë të shkresave sipërcituara, në bazë të “Rregullore për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, rezulton si më poshtë:

- Formatit dhe dokumentacioni për aplikim, është plotësuar nga aplikanti si më poshtë:

- Neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, pikat “i”, “ii”, “iii” dhe “iv”.

Plotësuar.

- Dokumentacioni dhe garancitë financiare dhe fiskale, është plotësuar nga aplikanti si më poshtë:
- Neni 9, pika 1, germa “e”, pikat “i”, “ii”, “v”, “vi”, “vii”. Plotësuar;
- Dokumente specifike për llojin e licencës, është plotësuar nga aplikanti si më poshtë:
- Neni 9, pika 2, germa “e”, paragrafi “iii” Plotësuar;

i) Nuk janë paraqitur nga subjekti “Dokumente specifike për llojin e licencës”, neni 9, pika 2, germa “i” Sasinë mesatare të gazit natyror të shprehur në milion Nm³, e parashikuar për t’u livruar gjatë një viti. dhe “ii” (garancinë që cilësia e gazit përmbush kriteret minimale të operatorit të sistemit).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Balkgaz” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë), për një afat 10-vjeçar.

2. Me fillimin e operimit të veprimtarisë së tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë), shoqëria të paraqesë në ERE sasinë mesatare të gazit natyror të shprehur në milion Nm³, e parashikuar për t’u livruar gjatë një viti, si dhe garancinë që cilësia e gazit përmbush kriteret minimale të Operatorit të Sistemit.

3. Në rastin e mospërmbushjes së këtij kushti nga ana e subjektit, ERE rezervon të drejtën e rishikimit të këtij vendimi

4. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut do të njoftojë të aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti